



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Tiranë, 03 Shkurt 2010

BERZH (Banka Evropiane per Rindertim e Zhvillim) do te financoje 50 milione Euro per Programin: “Rrugët Dytësore e Lokale”

Në datat 21 dhe 22 Janar një delegacion i Ministrisë së Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, ku merrnin pjesë Zv. Ministri i Financave z. Nezir Haldeda, z. Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv i FSHZH-se, si edhe staf teknik i dy institucioneve, realizuan një sere takimesh në zyrat qendrore të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), me qëllim negocimin e një kredie në kuadër të financimeve të donatorëve për projektin e rrugëve dytësore e lokale. Pas diskutimeve dy ditore rreth kushteve të kredisë e procedurave të zbatimit të projektit u firmosën minutat e negocimit. Kredia në shumën prej 50 milion Euro pritet të bëhet efektive pas miratimit final në Bordin e BERZH dhe ratifikimit në Parlamentin Shqiptar rreth muajit Maj të këtij viti.

Kredia prej 50 milion Euro nga BERZH është pjesë e një projekti të koordinuar prej 137 milionë Euro që do të mbështesin projektin e “Rrugëve Dytësore e Lokale”, që është në zbatim që prej vitit 2008. Projekti do të jetë bashkëfinancim me një tjetër kredi nga Banka Evropiane e Investimeve me po 50 milion Euro dhe me grante të Bashkimit Evropian nga IPA 2010 e 2011 me shumë prej 33 milion Euro. Një grant prej 4 milion Euro nga Western Balkan Investment Framework do të mbulojë kosto të tjera të lidhura me projektin si projektim-supervizion, asistencë teknike etj. Rreth 650 km rrugë dytësore e lokale parashikohet të rindërtohen nga ky projekt gjatë 5 viteve të ardhshme.

Projekti “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, është një bashkë financim i Bankes Botërore dhe donatoreve të tjerë me një vlerë të përafert prej 400 milion USD, dhe synon të përmirësojë e infrastrukturën rajonale dhe lokale në vend si edhe të rrisi aksesin ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rreth 1500 km rruge.

Aktualisht janë në proces implementimi 210 km rruge rajonale dhe lokale, ndërkohe që gjatë vitit 2010, parashikohet që të jenë rehabilituar apo të jenë në rikonstruksion 340 km rruge. Janë hartuar projektet teknike dhe dokumentacionet për prokurimin e 400 km, si edhe është përfunduar me sukses inventarizimi i 3500 km rruge rajonale dhe lokale duke ndërtuar një program që do të ndihmojë veçanërisht në priorizimin e investimeve bazuar në kritere objektive teknike.

Për më tepër informacion rreth ecurisë së projektit, mund të vizitoni faqen e internetit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit www.albaniandf.org ose na kontaktoni në adresën e e-mailit adf@albaniandf.org